



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Punimja/Prodato Received/Delivered	18.04.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSTIK	3638/2023		1/6



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.456/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.456/2023 të datës 03.03.2023 të parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit/Ministria e Drejtësisë, në çështjen juridike "Masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 18.04.2023, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.456/2022 e datës 03.03.2023 e parashtruar nga ankuesi**

**II. Shfuqizohet Vendimi KD.Nr.01/2023 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë i datës 09.02.2023.**

**III. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për zbatimin e këtij vendimi në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.**

**III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.**

## A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Drejtësisë, me datë 03.03.2023 përmes përfaqësuesit të autorizuar Avokat Hajzer Salihu ka parashtruar ankesë me numër protokollit 2292/2023 e regjistruar me shenjen A.nr.456/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër masës disiplinore të shqiptuar nga Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Drejtësisë përmes Vendimit të datës 09.02.2023 me shenjen KD.Nr.01/2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, me datë 15.03.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit te Ministria e Drejtësisë, ndërsa me datë 14.04.2023 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova:** Ankesën me shenjen A.nr.456/2023 me numër të protokollit 2292/2023 të parashtruar nga ankuesi me datën 03.03.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 07.02.2023 dërguar nga Sekretari i Përgjithshëm për Komisionin Disiplinor; Vendimin me shenjen KD.nr.01/2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë i datës 09.02.2023; Vendimin e Këshillit A.nr.948/2022 të datës 12.12.2022; Procesverbalin e seancës së datës 08 dhe 09.02.2023 të Komisionit Disiplinor; Vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 03.02.2023 për shtyrjen e afatit fillestar; Vendimin e Sekretarit të Përgjithshëm Nr.33/2022 të datës 03.03.2022; Vendimin e Sekretarit të Përgjithshëm ZSP-Nr.101/'22 të datës 07.09.2022; Vendimin e Sekretarit të Përgjithshëm ZSP-Nr.109/'22 të datës 23.09.2022; Ankesën me shenjen A.nr.948/2022 me numër të protokollit 6460/2022 të parashtruar nga ankuesi me datën 26.10.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 20.09.2022; Vendimin me shenjen KD.nr.5/2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë i datës 18.10.2022; Vendimin e datës 22.09.2022 të Kryesuesit të Komisionit Disiplinor; Procesverbalin e seancës së Komisionit Disiplinor i datës 22.09.2022; Vendimi i datës 23.09.2022 i Zv. Sekretarit të Përgjithshëm të MD-së; Vendimi i datës 07.09.2022 i Zv. Sekretarit të Përgjithshëm të MD-së; Vendimin e datës 03.03.2022 për themelimin e Komisionit Disiplinor i nxjerrë nga Zv. Sekretari i Përgjithshëm i MD-së; Shkresa përcjellës për iniciimin e procedurës disiplinore dërguar nga Njësia e Burimeve Njerëzore në Komisionin Disiplinor me datë 24.08.2022; E-maili i datës 24.08.2022 dërguar nga L.B për A.N; E-maili i datës 22.08.2022 dërguar nga G.N për L.B me përmbajtjen e shkrimit të postuar në Nacionale.com; E-maili datës 21.07.2022 dërguar nga L.G dërguar për Ministren e Ministrisë së Drejtësisë; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 31.10.2022; Përgjigjen e datës 09.11.2022 me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Akt emërimit të ankuesit i datës 08.09.2014; Konkursin e brendshëm i datës 24.04.2014; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë i datës 29.12.2021; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë i datës 22.01.2021; Vendimin e datës 06.09.2022 të nxjerrë nga Njësia e Burimeve Njerëzore e MD-së; E-mailin e datës 20.09.2022 dërguar nga A.N për ankuesin; E-mailin e datës 24.08.2022 dërguar nga A.N për ankuesin; E-mailin e datës 22.09.2022 dërguar nga përfaqësuesi i ankuesit për A.N; Procesverbalin e seancës e Komisionit Disiplinor të datës 14.10.2022; Përmbajtje e publikeve të bëra nga portali Nacionale.com; Postimin e ankuesit në rrjetin social "facebook"; Procesverbalin e seancës e Komisionit Disiplinor të datës 14.10.2022; Procesverbalin e seancës e Komisionit Disiplinor të datës 11.10.2022; Vendimi i Kryesuesit të Komisionit Disiplinor i datës 22.09.2022; Vendimin e datës 26.08.2022 të nxjerrë nga Njësia e Burimeve Njerëzore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e bashkangjitura të lëndës, konstatoi se ankesa e ankuesit, është e bazuar *sepse*:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në provat e administruara, gjegjësisht Akt Emërimit e datës 08.09.2014 ka konstatuar se ankuesi ka statusin e nëpunësit civil dhe mban pozitën e punës "Udhëheqës i Departamentit për Profesione të Lira në Ministrinë e Drejtësisë", ndërsa ndaj të njëjtit fillimisht Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Drejtësisë përmes Vendimit KD.nr.5/2022 të datës 18.10.2022 i ka shqiptuar masën disiplinore "Ndalim nga 20% të pagës për një periudhë deri në dy (2) muaj".

Ankuesi kundër Vendimit KD.nr.5/2022 të datës 18.10.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë, me datë 26.10.2022 kishte parashtruar ankesë në Këshillin e pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa Këshilli përmes Vendimit A.nr.948/2022 të datës 12.12.2022 e kishte aprovuar ankesën e ankuesit ndërsa lëndën e kishte kthyer në ri-shqyrtim dhe rivendosje tek organi i njëjtë. Tutje, me qëllim të zbatimit të vendimit të Këshillit, me datë 09.02.2023 Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Drejtësisë ka nxjerrë Vendimin KD.nr.01/2023 duke i shqiptuar ankuesit masën disiplinore "Ndalim nga 20% të pagës për një periudhë deri në një (1) muaj", me arsyetimin se ankuesi kishte bërë shkelje të rënda disiplinore të përcaktuara me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.6 dhe 3.8 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ndërlidhur me Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, mirëpo është për tu theksuar fakti se Komisioni Disiplinor vendimin e kishte marr me shumicë votash, ku anëtarja V.Humolli kishte votuar kundër.

Nga shkresat e administruara të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se Komisioni Disiplinor kërkesën për rishqyrtim të lëndës së ankuesit sipas Vendimit të Këshillit A.nr.948/2022 e ka pranuar me datë 10.01.2023 nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, ndërsa me datë 03.02.2023 ka nxjerr Vendimin me numër:02-818/11 përmes të cilit ka shtyrë afatin fillestar edhe për tridhjetë (30) ditë, gjegjësisht deri me 03.03.2023 duke iu referuar nenit 99 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Tutje, bazuar në procesverbalin e seancës së datës 08.02.2023 dhe 09.02.2023 konstatohet fakti se palët e përfshirë në këtë procedurë administrative nuk kanë qenë të ftuara në asnjërën seancë ngase mungon deklarimi i tyre.

Duke iu referuar dispozitave të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë nenit 12 paragrafi 4 dhe 5 lidhur me mbajtjen e seancave disiplinore ka përcaktuar se: "Seancat e Komisionit disiplinor janë të mbyllura përpos nëse parashihet ndryshe me Ligjin në fuqi dhe mbahen me praninë fizike të të gjithë anëtarëve siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. 5. Vendimi në komision disiplinor merret siç përcaktohet në dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative" andaj në kuptim të nenin 94 dhe 95 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Pala, në çdo fazë të procedurës, ka të drejtë të paraqesë mendime, shpjegime për faktet, rrethanat apo edhe çështjet ligjore, që kanë të bëjnë me procedurën përkatëse, së bashku me provat e dokumentet përkatëse, në të cilat i mbështet ato si dhe të paraqesë propozime për zgjidhjen e çështjes. 95.1 Para marrjes së një vendimi përfundimtar, organi publik që zhvillon procedurën administrative, duhet të njoftojë palën për të drejtën e saj për t'u dëgjuar", Kolegji i Këshillit ka ardhur në përfundimin se Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së Vendimit KD.nr.01/2023 duke mos i ftuar në seancë palët në procedurë ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e lartcekura ligjore si dhe në kundërshtim edhe me nenin 12 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3

të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë ku ndër tjerash përcaktohet se: *"Komisioni disiplinor kryen edhe këto veprime deri në marrjen e vendimit: Fton iniciuesin dhe nëpunësin civil ndaj të cilit është iniciuar procedura disiplinore për t'u njohur me variantin e tyre të ngjarjes apo të problemit"*, pasi që përmes vendimit të Këshillit A.nr.948/2022 të datës 12.12.2022 kur ishte shfuqizuar vendimi paraprak i Komisionit Disiplinor KD.Nr.05/2022 i datës 18.10.2022 dhe lënda ishte kthyer për rishqyrtim dhe rivendosje, gjegjësisht rasti ishte kthyer në pikën zero apo deri tek faza kur ishte iniciuar procedura disiplinore nga Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë me datë 24.08.2022, madje në Vendimin e Këshillit A.nr.948/2022 ishte konstatuar si shkelje procedural edhe mos kualifikimi i shkeljes së pretenduar disiplinore nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë sikurse përcaktohet me nenin 7 paragrafi 4 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë me rastin e inicimit të procedurës disiplinore.

Komisioni Disiplinor me rastin e rishqyrtimit të ankuesit së ankuesit kanë përfshirë edhe elemente të veprimeve të ankuesit të datës 27.08.2022 lidhur me apostrofimin e Ministrisë dhe menagjmentit të Ministrisë së Drejtësisë si dhe veprimet e datës 12.09.2022 lidhur me prononcimin publik të ankuesit në televizion, mirëpo në kërkesën e datës 24.08.2022 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë për inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit sikurse as në e-mailin e datë 22.08.2022 që është dërguar nga Genc Nimani -Shefi i kabinetit të Ministres për Zëvendësuesin e Sekretarit të Përgjithshëm, këto veprime apo elemente rënduese nuk ishin përfshirë, prandaj në kuptim të nenit 93 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"Pala mund të ndryshojë kërkesën e paraqitur, nëse qëllimi i kërkesës së ndryshuar bazohet në të njëjtën situatë faktike me kërkesën fillestare, apo edhe ta tërheqë plotësisht atë, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga organi publik. Nëse ka palë të tjera në procedurë, ato njoftohen"* ndërlidhur edhe me nenin 11 paragrafi 1 ku përcaktohet se Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë *"Komisioni disiplinor ka këto kompetenca: 1.1. Bënë shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura; 1.2. Përcakton dhe shqipton masën disiplinor"* Kolegji i Këshillit konstaton se këto veprime të Komisionit Disiplinor janë në kundërshtim me frymën e normave të lartcekura, ngase Komisioni Disiplinor nuk ka mandat të iniciojë procedurë disiplinore sipas detyrës zyrtare, ndërsa në rastin konkret procedura disiplinore është iniciuar me kërkesë të udhëheqësit të ankuesit, sikurse përcaktohet me nenin 48 paragrafi 4 nën paragrafi 4.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe nenit 7 paragrafi 4 dhe 5 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, andaj në rastin konkret Komisioni Disiplinor ka qenë i obliguar të rishqyrtojë procedurën e zhvilluar disiplinore vetëm sipas propozimit të iniciuesit të datës 24.08.2022 (e riformuluara me datë 07.02.2023 sa i përket kualifikimit të shkeljes), shtuar faktin kësaj që Komisioni Disiplinor pavarësisht që me veprimet e tij e ka rënduar situatën juridike të ankuesit, të njëjtit nuk i ka dhënë as mundësi të pjesëmarrjes në seancën e mbajtur disiplinore të datës 08.02.2023 dhe asaj të datës 09.02.2023 sikurse përcaktohet me nenin 95 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenit 12 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.

Po ashtu, lidhur me konstatimet e Komisionit Disiplinor se ankuesi ka bërë shkelje të rënda të detyrave të punës, përkatësisht ka shkelur dispozitat e nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.6 dhe 3.8 ku përcaktohet se: *"Shkelje të rënda konsiderohen: 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi"* dhe ka ardhur në përfundimin se Komisioni

Disiplinor i Ministrisë së Drejtësisë nuk ka arritur të përmbush mandatin në tij ligjor, detyrat funksionale dhe përgjegjësit e përcaktuara me nenin 11 paragrafi 1 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë sikurse: *“Komisioni disiplinor ka këto kompetenca: 1.1. Bënë shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura”* ngase termi *shkelje e përsëritur e rregullave dhe kryerje e përsëritur* të përcaktuara sipas dispozitave ligjore të lartcekura në mënyrë komulative janë të verifikueshme vetëm nëse për të njëjtat shkelje, ka pasur paraprakisht një konstatim sipas kritereve të përcaktuara të këtij ligji, ngase Kolegji i Këshillit nga shkresat e administruara të lëndës të dërguara nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore nuk ka arritur të konstatoi faktin nëse ankuesi në të kaluarën ka kryer shkelje disiplinore dhe për të njëjtat shkelje ka ndonjë masë aktive në fuqi, të shqiptuar qoftë nga Udhëheqësi i tij i Drejtpërdrejtë apo Komisioni Disiplinor, respektivisht nëse për një çështje të tillë nuk ka vendim përfundimtar të konfirmuar se ankuesi ka kryer edhe në të kaluarën shkelje disiplinore, andaj në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, Komisioni Disiplinor nuk mundet t’iu referohet këtyre dispozitave ligjore në rastin konkret, ngase të njëjtat norma përcaktojnë vetëm rastet e përsëritura dhe të konfirmuara përmes vendimeve përfundimtare në procedurë administrative të cilat e kanë marrë formën e ekzekutueshmërisë në kuptim të nenit 144 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nga rrjedh se Komisioni Disiplinor ka zbatuar gabimisht dispozitat e ligjit material në rastin konkret. Po ashtu, Kolegji i Këshillit thekson faktin se ankuesit, udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë i kishte shqiptuar Masa disiplinore *“Vërejtje”* me shenjen ZSP-Nr.67/2022 e datës 13.06.2022, mirëpo e njëjta masë disiplinore ishte shfuqizuar nga ana e Këshillit përmes Vendimit A.nr.576/2022 të datës 11.08.2022, ndërsa Vendimi i Këshillit ishte zbatuar, sikurse institucionin punëdhënës kishte nxjerr Vendimin DBNJ-Nr.16/2022 të datës 26.08.2022 për shuarjen e masës disiplinore i cili ishte zbatuar nga Ministria e drejtësisë.

Po ashtu, Komisioni Disiplinor me rastin e shqiptimit masës disiplinore ndaj ankuesit për shkak se të njëjtin e kishte gjetur përgjegjës për shkeljet disiplinore të përcaktuara me nenin 46 paragraf 3 nënë paragrafi 3.6 dhe 3.8 të ligjit material, ka vepruar në kundërshtim edhe me nenin 45 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik pasi që: *“Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. “ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;” 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit”* ngase elementet e përgjegjësisë disiplinore duhet të vlerësohen vetëm nëse të njëjtat janë konsumuar në mënyrë komulative, kurse Komisioni Disiplinor në arsyetimin e Vendimit KD.Nr.01/2023 të datës 09.02.2023 ka përmendur që masat disiplinore duhet të zbatohen në proporcion me dëmin e shkaktuar sikurse përcaktohet me dispozitat e Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, mirëpo në asnjë pjesë të vendimit të ankimuar Komisioni Disiplinor nuk ka arritur të konstatoi se cili është dëmi që iu është bërë sikurse nuk arritur të arsyetoj ndërlidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave pas administrimit të provave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, pas analizimit të dispozitave të ligjit material dhe dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sikurse dhe shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit dhe konstatimeve të dhëna në arsyetimin e këtij vendimi ka ardhur në përfundimin se ankesa e ankuesit është e bazuar, ndërsa Vendimi KD.nr.01/2022 i datës 09.02.2023 përmes të cilit Komisionit Disiplinor ankuesit i kishte shqiptuar masë disiplinore, është vendim i paligjshëm siç

përcaktohet edhe me nenin 52 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material", dhe si i tillë Vendimi KD.nr.01/2023 i datës 09.02.2023 i Komisionit Disiplinor është shfuqizuar si në dispozitiv të këtij vendimi, ndërsa ankesa e ankuesit është aprovuar si e bazuar për shkak të konstatimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit thekson faktin se nëse institucioni punëdhënës, respektivisht Ministria e Drejtësisë, nuk ka marr parasysh dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 130 paragrafi 1 ku përcaktohet se: "Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, parashtrimi i një ankese pezullon, sipas fuqisë së ligjit, prodhimin e pasojave juridike të aktit administrativ, deri në njoftimin e vendimit që zgjidh ankesën" dhe nëse Vendimin e Komisionit Disiplinor e ka ekzekutuar duke ia ndal ankuesit 20% të pagës, të njëjtit obligohen që t'ia kompensojnë shumën e ndaluar në emër të Vendimi KD.nr.01/2023 i datës 09.02.2023 të Komisionit Disiplinor, pasi që Këshilli ka konstatuar se vendimi si i tillë është i kundërligjshëm dhe se i njëjti nuk mund të prodhojë efekte juridike ndaj palës.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës dhe të gjeturave të pasqyruar si në arsyetim të këtij vendimin si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenit 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.456 /2023

**Flakron GASHI**  
  
Zyrtar i Lart për Bashkëpunim Profesional

**Eshref SHABANI**  
  
Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Avokatit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së